



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:260109
Datë: 12.11.2024
Numri i dokumentit: 06439789

C.nr.879/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Feim Bytyqi, si kryetar i kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridiko – kontestimore të paditësit M.S.M, nga fshati Senoc, Komuna e Rahovecit, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat S.M nga Prizreni, kundër të paditurës N.A.B, nga fshati Smallushë, Komuna e Lipjanit, Rr.”, me objekt kontesti zgjidhje e martesës, jashtë seancës me datën 12.11.2024, morri këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET POSHTË si e palejueshme padia e paditësit M.S.M, nga fshati Sencoc, Komuna e Rahovecit, në këtë çështje juridike, për shkak të ekzistimit të gjyqëvarësisë (litispendencës).

A r s y e t i m

Paditësi M.S.M, nga fshati Sencoc, Komuna e Rahovecit, përmes të autorizuarit të tij, në këtë gjykatë me datë 20.09.2024, kundër të paditurës N.A.B, nga fshati Smallushë, Komuna e Lipjanit, ka ushtruar padi, me bazë juridike zgjidhje e martesës.

E paditura N.A.B, përmes të autorizuarit së saj Av. E.A, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 30.10.2024, i ka propozuar gjykatës që të bëhet bashkimi i procedurës kontestimore, ashtu që lënda civile C.nr.879/2024, sipas padisë së paditësit M.M nga fshati Senoc, dhe lënda civile C.nr.873/2024, sipas padisë së paditëses N.A.B nga fshati Sllovijë, Komuna e Lipjanit të bashkohen dhe për këto dy lëndë civile të zbatohet procedurë e përbashkët.

Gjykata ka gjetur së paditësi M.S.M, nga fshati Sencoc, Komuna e Rahovecit, për çështjen e njëjtë pranë kësaj gjykatë me datë 03.09.2024 kishte ushtruar edhe një padi tjetër kundër të paditurës N.A.B, nga fshati Smallushë, Komuna e Lipjanit, e evidentohet me numër të lëndës C.nr.873/2024 (2024:266723). Gjithashtu gjykata ka gjetur së lënda me numër C.nr.873/2024 është në shqyrtim e sipër.

Gjykata pasi analizojë të dy lëndët C.nr.873/24 dhe C.nr.879/2024, gjeti së bëhet fjalë për çështjen e njëjtë, mirëpo meqenëse lënda C.nr.873/2024, është proceduar më herët dhe e njëjta gjendet në procedurë e sipër, atëherë gjykata vendosi ta hedhë poshtë padinë në këtë çështje për shkak të litispencës. Kjo gjykatë këtë padi e ka hedhur si të palejueshme duke u bazuar në nenin 391 pika c) të LPK-së sipas të cilit parashihet që *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: c) për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqëvarësia (litispendenca)”*.

Andaj, në bazë të gjendjes faktike dhe dispozitës së lartcekur si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 391 al. 1 pika 3., të LPK-së, është vendosur sikur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.879/2024, më datën 12.11.2024

B. Profesional
Armond Qmega

Kryetari i kolegjit - gjyqtari
Feim Bytyqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.